

## [ALBANIAN TEXT — TEXTE ALBANAIS]

## MARREVEESHJE MIDIS QEVERISE SE REPUBLIKES FRANCEZE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE MBI NXIT- JEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TE INVESTIMEVE

Qeveria e Republikës së Francës dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, këtu më poshtë të quajtura "Pales Kontraktuese".

Duke dëshiruar të forcojnë bashkëpunimin ekonomik midis dy vendeve dhe të krijojnë kushte të favorshme për investimet e shtetasve dhe shoqëritë të njërës Pale Kontraktuese në territorin dhe në zonën detare të Paleve të tjetër Kontraktuese.

Të bindur që nxitja dhe mbrojtja e këtyre investimeve shërbejnë për të nxitur transferimin e kapitaleve dhe të teknologjive midis dy vendeve, në interes të zhvillimit të tyre ekonomik ;

U moren vesh për dispozitat e mëposhteme :

### Neni 1 Percaktime

Për aplikimin e kesaj Marreveshjeje :

1 Termi "Investim" nënkorton çdo pasuri, si të mirat materiale, të drejtat dhe interesat e çdo natyre dhe, me në veçanti por jo ekskluzivisht :

a) pasuritë e tundshme dhe të patundshme, si dhe të gjitha të drejtat e tjera reale si hipotekat, privilegjet, të drejtën e përdorimit, dorezania dhe të drejta të tjera të ngjashme ;

b) aksionet, primet e emisioneve dhe forma të tjera të pjesëmarrjes, qoftë në minoritet ose indirekte, në shoqëritë e krijuara në territorin e njërës prej Paleve Kontraktuese ;

c) obligacionet, kredite dhe të drejtat që lindin nga çdo detyrim, që ka një vlerë ekonomike ;

d) të drejtat e pronësive intelektuale, tregtare dhe industriale si e drejta e autorit, patentat e shpikjeve, licencat, markat e depozituara, modelet dhe maketet industriale, procedurat teknike, know-how, emrat e depozituar dhe klientela ;

e) koncesionet e dhëna nga ligji ose mbi bazën e një kontrate, vecanerisht koncesionet në lidhje me kullimin, punimin, nuxhjen ose shfrytëzimin e pasurive natyrore, duke përfshirë edhe ato që gjenden në zonën detare të Paleve Kontraktuese.

Nënkuptohet që këto pasuri duhet të jenë ose të kenë qenë investuar në përputhje me legjislacionin e Paleve Kontraktuese në territorin ose në zonën detare të se ciles është kryer investimi. Dispozitat e kesaj Marreveshjeje aplikohen, gjithashtu, duke filluar nga hyrja e saj në fuqi, për investimet e realizuara përpara kesaj date.

Të gjitha modifikimet në formën e investimit të pasurive, nuk e prekin cilesinë e tij si investim, me kusht që ky modifikim të mos jetë në kundërshtim me legjislacionin e Paleve Kontraktuese në territorin ose në zonën detare të se ciles është realizuar investimi.

2. Termi "shtetas" nënkorton një person fizik që zoteron shtetësinë e njërës prej Paleve Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e saj.

3. Termi "shoqeri" nenkupton cdo person moral te krijuar ne territorin e njerës prej Paleve Kontraktuese, ne perputhje me legjislacionin e saj dhe qe ka aty seline sociale, ose kontrollohet drejtperdrejte ose indirekt nga shtetasit e njerës Pale Kontraktuese, ose nga personat morale qe kane seline e tyre sociale ne territorin e njerës prej Paleve Kontraktuese dhe eshte krijuar ne perputhje me legjislacionin e saj.

4. Termi "te ardhura" nenkupton te gjitha shumtat e prodhuara nga nje inves-tim, te tilla si, fitimet, interesat, mitjet e kapitalit, dividendet, shperblimet, honoraret, gjate nje periudhe te dhene.

Te ardhurat nga investimi dhe, ne rast nriinvestimi, te ardhurat nga ky nriinvestim gezojne te njejtën mbrojtje si dhe investimi.

5. Kjo marreveshje alikohet ne territorin e seciles nga Palet Kontraktuese si dhe ne zonen detare te seciles prej Paleve Kontraktuese, ketu me poshte percaktuar si zone ekonomike dhe shelfi kontinental qe shtrihen pertej kufirit te ujrave territoriale te seciles nga Palet Kontraktuese dhe mbi te cilet ato kane, ne perputhje me te Drejten Nderkombetare, te drejta sovrane dhe nje juridiksion me qellim kerkimi, shfrytezimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore.

#### Neni 2

##### Pranimi dhe Inkurajimi i investimeve.

Secila nga Palet Kontraktuese pranon dhe inkurajon, ne kuadrin e legjislacionit te saj dhe dispozitave te kesaj Marreveshje, investimet e kryera nga shtetasit dhe shoqerite e Pales tjeter ne territorin e saj dhe ne zonen e saj detare.

#### Neni 3

##### Trajtimi i drejte dhe i barabarte.

Secila nga Palet Kontraktuese angazhohet qe te siguroje, ne territorin dhe ne zonen detare te saj, nje trajtim te drejte dhe te barabarte, ne perputhje me parimet e te Drejtes Nderkombetare per investimet e shtetasve dhe shoqe-rive te Pales tjeter Kontraktuese dhe te beje te mundur qe ushtrimi i te drejtes tashme te njohur te mos pengohet as me ligj, as ne fakt. Ne vecanti, por jo ekskluzivisht, konsiderohen si shkelje te te drejtes apo te trajtimit te drejte dhe te barabarte, te gjitha kufizimet ne blerjen dhe transportin e lendeve te para dhe materialeve ndihmese, te energjise dhe lendeve djegese, si dhe mjeteve te prodhimit dhe te shfrytezimit te cdo lloji, te gjitha pengesat ne shfajten dhe ne transportimin e produkteve brenda vendit dhe jashte, si dhe te gjitha masat e tjera qe kane nje efekt te ngjashem.

Palet Kontraktuese do te ekzaminojne me dashamiresi, ne kuadrin e legjislacionit te tyre te brendshem, kartesat per hyrje dhe per autorizim per qendrim, per pune dhe qarkullim te paraqitura nga shtetasit e njerës Pale Kontraktuese, ne lidhje me nje investim te realizuar ne territorin apo ne zonen detare te Pales tjeter Kontraktuese.

#### Neni 4

##### Klauzola e Kombit me te favorizuar dhe trajtimi kombetar.

Secila Pale Kontraktuese aplikon, ne territorin e saj dhe ne zonen e saj detare, per shtetasit apo shoqerite e Pales tjeter, persa i perket investimeve te tyre dhe aktiviteteteve qe lidhen me keto investime, nje trajtim jo me pak te favorshem se sa ai qe i akordohet shtetasve dhe shoqerive te saj (trajtimi kombetar), ose trajtimi qe i akordohet shtetasve apo shoqerive te Kombit me te favorizuar (klauzola e Kombit me te favorizuar), ne qofte se ky eshte me i levertdashem. Ne kete kuptim, shtetasit te autonizuar qe te punojne ne territorin dhe zonen detare te njerës prej Paleve Kontraktuese, duhet te mund te perfitojne lehtesira materiale te pershiateshme per ushtrimin e aktivitetit te tyre profesional.

Megjithate ky trajtim nuk shtrihet per privilegjet qe nje Pale Kontraktuese i jep shtetasve apo shoqerive te nje Shteti te trete, mbi bazen e pjesemarrjes ose bashkimit te saj ne nje zone te kembimit te lire, nje bashkimi doganor nje tregu te perbashket ose cdo forme tjeter te organizimit ekonomik rajonal.

Dispozitat e ketij Neni nuk aplikohen per problemet tatimore.

#### Neni 5

##### Shtetezimi, shpronosimi ose masa te shpronosimit

1. Investimet e kryera nga shtetasit apo shoqerite e njeres apo tjetres Pale Kontraktuese gezojne, ne territorin dhe ne zonen detare te Pales tjetere Kontraktuese, nje mbrojtje dhe nje siguri te plote dhe teresore.

2 a) Palet Kontraktuese nuk mamin masa shpronosimi apo shtetezimi ose cdo mase tjeter, efekti i se ciles eshte qe te shpronesoje, drejtperdrejte ose indirekt, shtetasit dhe shoqerite e Pales tjetere nga investimet qe ju perktuon ato, ne territorin e tyre dhe ne zonen e tyre detare, me perjashtim te rastit kur kryhet per shkak te nevojave publike dhe me kusht qe keto masa te mos jene as diskriminuese, as ne kundërshtim me nje angazhim te vecante.

b) Te gjitha masat e shpronosimit qe mund te merren duhet t'i hapin rrugen nje pagese te shpejte dhe te pershtateshme, shuma e te ciles, e barabarte me vleren reale te ketyre investimeve, duhet vleresuar ne raport me nje situete ekonomike normale dhe perpara te gjitha rreziqeve te shpronosimit.

Ky demshperblim, shuma e tij dhe modalitetet e derdhjes se tij fiksohen jo me vone se data e shpronosimit. Ky demshperblim eshte efektivisht i reali-zueshem, i derdhshem pa vonese dhe lirisht i transferueshem. Ai prodhon, deri ne daten e derdhjes, interesa te flogaritura me perqindjen e interesit te tregut, te pershtateshem.

#### Neni 6

##### Kompesimi i demeve dhe humbjeve

Shtetasit apo shoqerite e njeres prej Paleve Kontraktuese, investimet e te cileve kane pesuar humbje per shkak te luftes ose cdo konfliktit te armatosur, revolucionit, gjendjes se jashtezakonshme kombetare ose revoltave qe ndodhin ne territorin ose ne zonen detare te Pales tjetere kontraktuese, do te perfitojne nga ana e kesaj te fundit nje trajtim jo me pak te favorshem se sa ai qe ju akordohet shtetasve apo shoqerive te saj apo atyre te kombit me te favortuzuar.

#### Neni 7

##### Transferimet

Çdo Pale Kontraktuese ne territorin apo zonen detare te se ciles jane kryer investime nga shtetas apo shoqerit te Pales tjetere Kontraktuese, i akordon ketyre shtetasve apo shoqerive transferimin e lire :

a) te interesave,dividenteve,fitimeve dhe te ardhurave te tjera korenta; percaktuara ne paragrafin 1, shkronja d) dhe e) te nenit 1 ;

c) te derdhjeve te kryera per nimbursimin e huave te kontraktuara rregullisht ;

d) te produktit te cedimit ose te likuidimit te plote ose te pjesshem te investimit, duke perfshire edhe vleren e shtuar te kapitalit te investuar ;

e) te demshperblimit per shpronosimet ose humbjet e parashikuara ne nenin 5, paragrafet 2 b) dhe Neni 6, si me siper.

Shtetasit e seciles nga Palet Kontraktuese, qe jane autorizuar te punojne ne territorin apo ne zonen detare te Pales tjeter Kontraktuese, ne kuadrin e nje investimi te pranuar, autorizohen gjithashtu te transferojne ne vendin e tyre te origjines nje sasi te pershtateshme te shperblimit te tyre.

Transferimet e parashikuara ne paragrafet e mesiperme kryhen pa vonese me kursin normal te kembimit, zyrtarisht te aplikueshem ne daten e transferimit.

#### **Neni 8 Garantimi i Investimeve.**

Ne masen qe legjislacioni i njeres prej Paleve Kontraktuese parashikon nje garanci per investimet e kryera jashte shtetit kjo mund t'u akordohet ne kuadrin e nje shqyrtimi rast per rast per investimet e kryera nga shtetasit apo shoqerite e kesaj Pale ne territorin apo ne zonen detare te Pales tjeter.

Investimet e shtetasve dhe shoqerive te njeres prej Paleve Kontraktuese ne territorin apo ne zonen detare te Pales tjeter mund t'a marrin garancine e permendur si me siper, vetem ne qofte se kane marre me pare aprovimin e kesaj te fundit.

#### **Neni 9 Rregullimi i mosmarveshjeve ne lidhje me Investimet.**

Te gjitha mosmarveshjet ne lidhje me investimet midis njeres prej Paleve Kontraktuese dhe nje shtetasi ose nje Shoqerie te Pales tjeter Kontraktuese zgjidhen miqesisht midis dy Paleve te prekura.

Ne qofte se nje mosmarveshje e tille nuk mund te zgjidhet brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filuar nga momenti kur ajo eshte ngritur nga njera prej Paleve ne mosmarveshje, Pala Kontraktuese qe eshte Pale ne mosmarre-veshje lejon per cdo kerkese te shtetasve ose shoqerive Pale ne mosmarveshje, qe t'ia nenshtrojne ate per zgjidhje apo arbitrazh, Qendres Nderkombetare per Rregullimin e mosmarveshjeve ne lidhje me investimet(C.I.R.D.I.), te krijuar nga Konventa per rregullimin e mosmarveshjeve ne lidhje me investimet midis shteteve dhe shtetasve te shteteve te tjera, e nenshkruar ne Uashington me 18 mars 1965.

#### **Neni 10 Zevendesimi me te drejta te plota.**

Ne qofte se njera nga Palet Kontraktuese, mbi bazen e nje garancie te dhene per nje investim te realizuar ne territorin apo ne zonen detare te Pales tjeter kryhen derdhje parash per llogari te nje prej shtetasve te saj ose per nje nga shoqerite e saj, ajo eshte ne kete menyre zevendesuese e te drejtave dhe veprimeve te ketij shtetasi, apo kesaj shoqerie.

Keto derdhje nuk prekin te drejtat e perfituesit te garancise qe t'i drejtohet C.I.R.D.I.-se, ose te ndjeke veprimet e paraqitura perpara tij deri ne perfundimin e procedurave.

#### **Neni 11 Rregullimi i mosmarveshjeve midis Paleve Kontraktuese.**

1 Mosmarveshjet ne lidhje me interpretimin apo aplikimin e kesaj Marveshjeje, duhet te rregullohen per sa eshte e mundur nepermjet konsultimeve midis Paleve Kontraktuese ose ne ruge diplomatike.

2. Ne qofte se brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga momenti i ngritjes se saj nga njera ose tjetra Pale Kontraktuese, mosmarveshja nuk eshte zgjidhur, ajo i nenshtrohet me kerkese te njerese ose tjetres Pale Kontraktuese nje gjykate arbitrazhi.

3. Kjo gjykate do te krijohet per cdo rast te vecante ne menyren e meposhteme: Cdo Pale Kontraktuese percakton nje anetar dhe te dy anetaret percaktojne me nje marveshje te perbashket shtetasin e nje shteti te trete, i cili emerohet President i Gjykates, nga te dy Palet Kontraktuese. Te gjithete anetaret duhet te emerohen brenda nje afati prej 2 muajsh duke filluar nga data ne te cilen nje nga Palet Kontraktuese i ka bere te ditur Palet tjetere Kontraktuese qellimin e saj, qe t'ia nenshtroje mosmarveshjen arbitrazhit.

4. Ne qofte se afati i caktuar ne paragrafin 3 ketu me siper nuk eshte mbajtur parasysh njera apo tjetra Pale Kontraktuese, ne mungese te cdo Marveshjeje, fton Sekretarin e Pergjithshem te Organizates se Kombeve te Bashkuara te beje emerimet e nevojshme. Ne qofte se Sekretari i Pergjithshem eshte shtetas i njerese apo tjetres Pale Kontraktuese, ose per nje aresye tjetere ai ndalohet te ushtroje kete funksion. Zevendesekretari i Pergjithshem, me i vjeter, dhe qe nuk ka shtetesine e ndonjeres nga Palet Kontraktuese, ben emerimet e nevojshme.

5. Gjykata e arbitrazhit i merr vendimet e saja me shumice votash. Keto vendime jane perfundimtare dhe te zbatueshme me te drejte te plote per Palet Kontraktuese.

Gjykata e arbitrazhit percakton vete rregullat e saj. Ajo interpreton Vendimin me kerkesen e njerese ose tjetres Pale Kontraktuese. Me perjashtim te rasti kur Gjykata vendos ndryshe, duke mbajtur parasysh rrethanat e vecante, shpenzimet e procedurave se arbitrazhit duke perfshire edhe shperblimin e arbitrave, ndahen ne menyre te barabarte ndis Paleve Kontraktuese.

#### Neni 12 Angazhime te vecanta.

Investimet qe jane bere objekt i nje angazhimi te vecante te njerese prej Paleve Kontraktuese, perfundimi shtetasve dhe shoqerive te Paleve tjetere Kontraktuese, rregullohen pa paragjykim nga dispozitat e kesaj Marveshjeje, nga termat e ketyre angazhimeve, ne masen qe ato perbejne dispozita me te favorshme se ato qe parashikohen nga kjo Marveshjeje.

#### Neni 13 Hyrja ne fuqi, zgjatja dhe perfundimi.


Secila nga Palet do t'i beje te ditur tjetres pembushjen e procedurave te brendshme, te nevojshme per hyrjen ne fuqi te kesaj Marveshjeje, qe do te hyje ne fuqi nje muaj pas dites se marrjes se njoftimit te fundit.

Marveshja eshte perfunduar per nje zgjatje fillestare prej 10 vjetesh. Ajo do te qendroje ne fuqi pas kesaj afati, me perjashtim te rasti kur njera nga Palet e denoncon ne rruge diplomatike me nje paralajmerim prej nje viti.

Me perfundimin e vlefshmense te kesaj Marveshjeje, investimet e kryera gjate kohes qe ajo ishte ne fuqi, do te vazhdojne te perfitojne nga mbrojtja e dispozitave te saj, per nje penudhe suplementare prej 20 vjetesh.

Bere ne Paris, me 13 qershor 1997,  
ne dy kopje origjinale, secila ne gjuhen shqipe  
dhe ne gjuhen frenge, te dy tekstet kane  
fuqi te barabarte.

Per Qeverine  
e Republikes Franceze:



Per Qeverine  
e Republikes se Shqiperise:

